

VENDIM
Nr. 633, datë 25.9.2019

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I KOMPLEKSIT TË SHKOLLAVE DHE TERRENEVE SPORTIVE FIER SHEGAN”, LUSHNJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i kompleksit të shkollave dhe terreneve sportive Fier Shegan”, Lushnjë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme që shpronësohen, për pasurinë e llojit “tokë arë”, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë të përgjithshme 60 060 (gjashtëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 60 060 (gjashtëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë si dhe hartën treguese të regjistrimit, në Bashkinë Lushnjë.

8. Bashkia Lushnjë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara në kontratën e lidhur nga Bashkia Lushnjë me sipërmarrësit e punimeve.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasurinë e shpronësuar, në favor të shtetit (Bashkia Lushnjë).

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasurinë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, si dhe Bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**Lista e bashkëpronarëve të pasurisë pronë private që shpronësohet,
pasi preket nga realizimi i projektit “Ndërtimi i segmentit rrugor
‘Komuna e Parisit–rruga e re Tiranë–Elbasan’ (shtesa)
‘Rikonstruksioni i Kompleksit të Shkollave dhe
Terreneve Sportive Fier Shegan’, Lushnjë**

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr/pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi	Vlera totale / lekë	Shënime Konfirmuar ose jo nga nga ZVRPP- ja
					Tokë arë / m²	Tokë arë /m²		
1	Bp. Dritan Zenel Myzeqari Besnike Zenel Topi, Naxhije Zenel Paja, Ervehe Zenel Biçakaj, Adem Zenel Myzeqari, Feride Zenel Sharka, Shaqire Zenel Murdarasi, Merjeme Zenel Hysa	1615	283/10	851	165	364	60,060	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Vlera totale e shpronësimit							60,060	